РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

ДКСК KSHPK
ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА
KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë: KSHPK) në vazhdimin e parë të seancës së pesëdhjetë e tetë të mbajtur më 28.12.2021 miratoi

Vendim

Procedura për lëndën me nr. 08-4346 / 1 datë 30.10.2021, NDËRPRITET.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së për lëndën me numër 08-4346/1 datë 30.10.2021.

Lënda me numër 08 –4346/1 të datës 30.10.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-4346 / 1 të datës 30.10.2021 është formuar me vetiniciativë .

Nga mbikëqyrja e evidencave të saj, KSHPK-ja ka konstatuar se personi ____________ nuk ka dorëzuar fletë anketuese në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në afatin e paraparë me ligj prej 30 ditësh pasi është zgjedhur anëtar ------------------------------------------------------.

KSHPK-ja përpiloi raport për kundërvajtjen dhe urdhërpagesën e konstatuar ia dorëzoi personit _________. Më datë 20.12.2021 ka paguar gjobën në shumën e shënuar në urdhërpagesë për kundërvajtje.

KSHPK, pas shqyrtimit të lëndës, konstaton se nuk ka elemente për veprimin e saj të mëtejshëm kompetent në rastin konkret.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti:Mr. Nikolina Tarçullovska-Miloshevska, këshilltare
Miratoi: Nuri Bajrami, anëtar

KOMISIONI SHTETROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut
email: contact@dksk.org.mk
тел/tel: +389 2 3248 930
https://www.dksk.org.mk